

PERMBLEDHJE JO TEKNIKE E RAPORTIT
TE VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR AKTIVITETIN:

Vendodhja: Guri Bardhe, Dimal (Ura
Vajguore), Berat.

**“PRODHIM I GELQERES ME FURRE
VERTIKALE NGA DIEGIA E GURIT
GELQEROR ME QYMYR KOKSI”**

Kërkues: Z. Petrit Mamushi (Person Fizik)

Hartoi raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis:

“ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS” Sh.p.k

Administrator

Elidiana Shehu

Dhjetor, 2021

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
1. QËLLIMI I HARTIMIT TË RAPORTIT TË VNM DHE LEGJISLACIONI I KONSULTUAR	4
1.1 Qëllimi i projektit	4
1.2 Qëllimi i hartimit të raportit VNM	4
1.3 Kuadri ligjor dhe institucional i kryerjes së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis	5
1.3.1 Kuadri ligjor	5
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TEKNIK	7
2.1. Vendodhja e aktivitetit	7
2.2. Te dhena te pergjithshme	9
2.3. PERSHKRIMI TEKNOLOGJIK I AKTIVITETIT	10
3. PËRSHKRIMI I MJEDISIT NË ZONË	11
5.1. Mjedisi fizik	11
5.1.1 Gjeologjia	11
3.1.2 Gjeomorfologjia	12
3.1.3 Tokat	12
3.1.6. Ujërat	12
3.1.7. Klima	13
3.1.8. Zhurma	13
3.2 Mjedisi biologjik	13
3.2.1 Habitatet e zonës në studim	13
3.2.2 Fauna e zones	13
3.2.2 Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës	14
3.4 Mjedisi social	14
4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS	15
4.1 Metodika e aplikuar për vlerësimin e ndikimeve në mjedis	15
4.2 Përcaktimi i sinjifikancës së ndikimeve	16
4.3. Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis	17
4.3.1 Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis gjatë transportit të lendeve te para dhe produktit perfundimtare	17
4.3.2 Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis gjatë depozitimit në aktivitet te lendeve te para	18
4.4. Kategorizimi i ndikimeve të identifikuar (sinjifikanca)	18
4.5 Kohëzgjatja e mundshme e ndikimeve negative të identifikuar	19
4.6 Shtrirja e mundshme hapsinore e ndikimeve negative në mjedis	19

HYRJE

Z. PETRIT MAMUSHI (Personi Fizik), me seli në Berat, Dimal (Ura Vajgurore), është një shoqëri që prej vitesh ushtron aktivitet në të njëjten vendodhje në fushën e e prodhimit dhe tregtimit të gelqeres dhe materialeve ndertimore. Shoqëria ka një eksperincë shumëvjeçare në këto fushe, kryesisht në prodhimin dhe tregtimin e gelqeres brenda Qarkut Berat, dhe shpërndarjen e saj në të gjithë territorin e shqipërisë. Përgjatë viteve shoqëria ka krijuar përvojë të konsiderueshme në teknologjinë e prodhimit të gelqeres dhe ka investuar në mirëmbajtjen dhe funksionimin e teknologjisë OFMAN me furra Vertikale. Teknologjia e përdorur në ndërtimin e kësaj furre është teknologji e viteve 40 dhe teknologjia e këtyre llojeve të aktivitetesh nuk ka ndryshuar pasi parimi i punës është i njëjti.

Z. Petrit Mamushi ka trashëguar një aktivitet brenda një sipërfaqe dhe territori në zone industriale, ku realizon prodhimin e gelqeres brenda parametrevë të nevojshme për këto aktivitet. Ky aktivitet ndodhet në Bashkinë Dimal (Ura Vajgurore), Qarku Berat, i pajisur me parë me Autorizim Mjedisor.

Zona ku ushtrohet aktiviteti ka destinacion industriale, ku janë të përdorura shumë aktivitete të tjera industriale, kryesisht në fushën e shfrytëzimit dhe prodhimit të materialeve inerte.

Trualli në të cilin ndodhet aktiviteti, shtrihet në një terren të rrafshët ndërsa prona është e karakterizuar nga një sipërfaqe uniforme ku efekti i erozionit nuk është i ndjeshëm, prona është në pronësi të Z. Petrit Mamushi, truall me sipërfaqe 160 m².

Subjekti ka vite që ndodhet në këto ambiente dhe zhvillon aktivitetin "Prodhim dhe Tregtim Gelqere". Në afërsi të zonës ku ndodhet aktiviteti nuk ka shkollë, vepra arti, argjentinë, linje elektrike dhe linje uji që mund të demtohen nga zhvillimi i aktivitetit në fjalë.

Permiresimi urban i kësaj zone, e cila ka patur zhvillime mjaft të mëdha e të shpejta, urbanistike dinamike, kohët e fundit ka tërhequr mjaft interesin e subjekteve private.

Ky aktivitet është ekzistues dhe vetë instalimi është teknologji e viteve 40 me një jetëgjatësi 100 vjeçare, dhe subjekti Petrit Mamushi (Person Fizik) ka realizuar edhe punime remonti e rikonstruksioni me kalimin e viteve për prodhimin e Gelqeres me furra vertikale si dhe investimin e vendosjen e filtrave për kapjen e grimcave në ajër.

1. QËLLIMI I HARTIMIT TË RAPORTIT TË VNM DHE LEGJISLACIONI I KONSULTUAR

1.1 Qëllimi i projektit

Projekti i hartuar ka për qëllim lejimin e vijimit të zhvillimit të aktivitetit ekzistues “Shuarja e Gelqeres në Furra Vertikale” në afërsi të Gurit të Bardhe, Bashkia Dimal (Ura Vajgurore), Qarku Berat. Z. Petrit Mamushi (Person Fizik).

Furrat e Gelqeres ndodhen në Jug Lindje të qytetit Dimal (Ura Vajgurore), në një distancë rreth 850 m larg në vijë ajrore prej saj. Siperfaqja e aktivitetit në anën jug lindore të saj kufizohet me një sipërfaqe të tokës së pashfrytezuar dhe pas tij në një distancë prej 170 m në vijë ajrore kalon rrjedha ujore e lumit Osum. Ndërsa në anën Veriore, jugore dhe perëndimore kufizohet me aktivitete industriale, të përdorura në industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit të gurit gelqerorë (si Salillari etj).

Relievi i zonës ku gjendet objekti është kodrinor me ngritje të butë në drejtimin veriperëndim-juglindje.

Sipërfaqja paraqitet e përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit Prodhim Gelqere, pasi është një zonë industriale ku janë të përdorura aktivitetet si: shfrytëzim, përpunim dhe prodhim i materialit inertë të cilat përdoren kryesisht në fushën e ndërtimit si një nga kriteret bazë të këtij lloji të aktivitetit i cili duhet të jetë pranë lëndës së parë.

1.2 Qëllimi i hartimit të raportit VNM

Synimi kryesor i kryerjes së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projektit të propozuar, është konsiderimi i çështjeve që lidhen me mjedisin që në fazat e para të tij. Në thelb të vlerësimit mjedisor të projektit qëndron evidentimi i pikëprerjeve të tij me legjislacionin në fuqi, vlerat natyrore që gjenden në zonën e projektit dhe si e sa do të ndikohen në rast të zbatimit të tij. Nëpërmjet identifikimit të ndikimeve të mundshme negative të zbatimit të tij në vlerat natyrore të zonës pritëse, që në fazën e projektimit mund të merren masa të nevojshme për përmirësimet e duhura teknologjike, me qëllim zbutjen e ndikimeve dhe përshtatjen e saj me kapacitetin bartës të mjedisit. Ky vlerësim arrihet përmes:

- Evidentimit të pikëprerjeve dhe bashkërendimit të projektit me kuadrin rregullator legjislativ kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit;
- Identifikimit të statusit mbrojtës të zonave ku do të zhvillohet projekti;
- Përshkrimin të vlerave natyrore dhe mjedisore në zonën e projektit;
- Identifikimit të ndikimeve të mundshme thelbësore negative në vlerat natyrore dhe në mjedis duke propozuar njëkohësisht masa për zbutjen e tyre dhe mbrojtjen e mjedisit nga këto ndikime.

Raporti i VNM përmbledh një përshkrim të projektit të propozuar, përshkrimin e karakteristikave të mjedisit pritës ekzistues, analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis të projektit të propozuar, planin e masave për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve të mundshme negative dhe programin e monitorimit mjedisor.

1.3 Kuadri ligjor dhe institucional i kryerjes së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

1.3.1 Kuadri ligjor

- Ligj nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Neni 25, i cili përcakton kërkesën për vlerësimin e ndikimit në mjedis, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkit të lejeve përkatëse të zhvillimit;
- Ligj nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, i cili përcakton dhe specifikon kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis, projektet që i nënshtrohen, përgjegjësitë e palëve në proces;
- Ligj nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i cili ka për qëllim të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut si dhe të sigurojë administrimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet nëpërmjet menaxhimit të integruar të tyre; Ligj nr.8897 datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i cili sanksionon që personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, vendas ose të huaj, kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e ajrit, ta mbrojnë atë nga ndotjet e shkaktuara nga veprimtaria që ushtrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Ligj nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i cili përcakton kërkesat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma, mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma;
- Ligji nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i cili ka për qëllim të përmirësojë shëndetin publik dhe të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet integritit të çështjes së mbrojtjes së ajrit në politika të tjera, si dhe përcaktimit të kërkesave për pakësimin e shkarkimeve, monitorimin, vlerësimin, planet e cilësisë së ajrit, dhe për bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar për këtë qëllim;
- Ligj Nr. 68/2014 Për disa Shtesa dhe Ndryshime Në Ligjin Nr. 9587, Datë 20.7.2006, “Për Mbrojtjen E Biodiversitetit”, Të Ndryshuar, i cili kërkon ruajtjen dhe mbrojtjen e specieve biologjike dhe mbrojtjen e vlerave biologjike ku përfshihen edhe ekosistemet dhe habitatet. Ligji kërkon që veprimtaritë ose përdorimet e reja në ekosisteme, habitate dhe peizazhe të mbrojtura ose jo të mbrojtura mund të ushtrohen vetëm pasi t'u jenë nënshtruar procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të jenë pajisur me leje mjedisore;
- LIGJ Nr. 57/2020 “PËR PYJET” Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrime me interes kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Ligji nr.81 datë 04.05.2017 "Për zonat e Mbrojtura", përmes të cilit synohet të sigurohet mbrojtje e veçantë për përbërës të rëndësishëm të rezervave natyrore, të biodiversitetit dhe të natyrës, në tërësi, nëpërmjet krijimit të zonave të mbrojtura. Zhvilluesit e projekteve dhe veprimtarive duhet të zbatojnë projektet e tyre në përputhje me statusin e mbrojtjes së zonave të mbrojtura (duhet të evidentohet prania ose jo e tyre në zonën e projektit dhe masat që duhen marrë);


- Ligjin Nr.6/2018 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr.111/2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore", i cili ndër të tjera ka si qëllim mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja.
- Vendim Nr. 352, datë 29.4.2015 “Për Vlerësimin e Cilësisë Së Ajrit Të Mjedisit Dhe Kërkesat Për Disa Ndotës Në Lidhje Me Të”
- Vendim Nr. 248, Datë 24.4.2003 “Për Miratimin e Normave te Përkohshme te Shkarkimeve në Ajër dhe zbatimin e tyre” (per industrite)
- Vendim Nr.803, datë 04.12.2003 "Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit"
- VKM nr.247 datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”;
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr.8 datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.
- Udhëzim Nr.1037/1, Datë 12.4.2011 “Për Vlerësimin dhe Menaxhimin e Zhurmës Mjedisore”
- Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis”.
- Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”.
- Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- VKM nr.229 datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”;
- Vendim nr 575 datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- Vendim nr.686, date 29.07.2015, “Per miratimin e rregullave, të përgjegjësiive dhe afateve për zhvillimin e proçedures së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe proçedures së transferimit të vendimit të deklarates mjedisore”.
- Vendim nr.402 datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të klasifikimit të mbetjeve” në të cilin kategorizohen tipet e mbetjeve dhe kriteret për klasifikimin e tyre;

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TEKNIK

2.1. Vendodhja e aktivitetit

Sipërfaqja ku zhvillohet aktiviteti ndodhet në rajonin qendror-jugor të vendit, në rrethin e Beratit, Bashkia Dimal (Ura Vajguore).

Sipërfaqja ku zhvillohet aktiviteti është 160 m², Nr, pasurie 9/304, zone kadastrale 3682, e ndodhur në zonen e quajtur Guri i Bardhe, Bashkia Dimal (Ura Vajguore), Qarku Berat .



Pozicioni i aktivitetit në hartën topografike



Figura 1 Ortofoto e sipërfaqes së aktivitetit

Koordinatat e sipërfaqes ku zhvillohet aktiviteti në sistemin Albanian 1986 Gauss-Kruger, zonë 4

PRONA				
Sistemin Gauss-Kruger			krëgjsh	
Nr	X	Y	X	Y
1	4405901	4514997	490207	4514274
2	4405892	4514988	490198	4514264
3	4405883	4515003	490189	4514280
4	4405892	4515007	490197	4514284
5	4405896	4514999	490202	4514275

Figura 2 Koordinatat e sipërfaqes

Kjo zonë është e pa pëllëzuar, pa asnjë llojë bimesie, pa objekte banimi e industriale dhe nuk gëzon ndonjë status të veçantë. Sipërfaqja e aktivitetit është e lidhur me rrugë makine të pa asfaltuar por në gjendje të mirë. Relievi i zonës së studiuar është kodrinor i ulët dhe nuk është i rrethuar pasi jemi pranë një terreni të sektorit minierar .

2.2. Te dhena te pergjithshme

Projekti i paraqitur nga Z. Petrit Mamushi ka per qellim prodhimin dhe tregtimin e gelqeres ne furre vertikale e cila perdoret si lende e pare dhe si lende ndihmese ne proceset e ndryshme teknologjike, si dhe te pasqyroje ndikimet e mundeshme ne shendet dhe mjedis gjate ketij aktiviteti . Guri gelqeror ose shkurt gelqerori eshte mineral qe bene pjese ne grupin e shkembinjve te sedimentuar dhe qe perbehet kryesisht prej karbonatit te kalciumit.

Llojet me te pastra te gurit gelqeror permbajne edhe deri ne 99% CaCO₃ (karbonat kalciumi).

Gelqerja si material lidhes prodhohet me zberthimin termik te gurit gelqeror. Varesisht prej temperatures se procesit te zberthimit termik dhe prej perberjes se lendes se pare natyrore, dallojme disa lloje te gelqeres. Nje synim tjetër i ketij relacioni eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike organizative per zbutjen e ndikimeve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit.

Per te realizuar respektimin e mjedisit dhe per te ulur ndikimin e impaktit ne mjedis, Z. Petrit Mamushi ka siguruar metoda, mjete dhe makineri bashkekohore per zhvillimin e aktivitetit. Siperfaqja e sheshit ku zhvillohet aktiviteti eshte **160 m²**, e percaktuar kjo ne dokumentin e pronensise ZVRPP Berat, shiko figuren me poshte:




Figura 3 Planimetrite

2.3. PERSHKRIMI TEKNOLOGJIK I AKTIVITETIT

Si lende e pare per prodhimin e gelqeres perdoret guri gelqeror - karbonati i kalciumit (CaCO₃) i cili sigurohet nga subjekti I kontraktuar "MUSTAFAJ" sh.p.k per gurin gelqeror dhe subjektin e kontraktuar RDA sh.a Petrol ne Ballsh per qymyrin e koksit ne varesi te kerkesave.


Guri gelqeror ose shkurt gelqerori eshte mineral qe bene pjese ne grupin e shkembinjve te sedimentuar dhe qe perbehet kryesisht prej karbonatit te kalciumit. Llojet me te pastra te gurit gelqeror permbajne edhe deri ne 99% CaCO₃ (karbonat kalciumi).

Gelqerja si material lidhes prodhohet me zberthimin termik te gurit gelqeror. Varesisht prej temperatures se procesit te zberthimit termik dhe prej perberjes se lendes se pare natyrore, dallojme disa lloje te gelqeres.

- gelqerja ajrore,
- gelqerja hidraulike,
- gelqerja magnezite dhe c) gelqerja dolomite.

Gelqerja ajrore prodhohet duke pjekur gurin gelqeror qe permban deri ne 8 % deltine ne temperaturen e aglomerimit.

Procesi i pjekjes i cili behet deri ne temperaturen 800- 900°C zhvillohet sipas reaksionit:




Gelqerja hidraulike prodhohet duke pjekur gurin gelqeror qe permban 8-10% deltine deri ne temperaturen 900—1000°C.

Gelqerja magnezite ose gelqerja qe shuhet ngadale prodhohet me pjekjen e gurit gelqeror te dolomitizuar. Ky lloj i gelqeres permban deri ne 7% MgO.

Gelqerja dolomite sikurse tregon edhe emri i saj prodhohet duke pjekur dolomitin ne temperature rreth 900°C dhe eshte nje perzierje e oksideve te magnezit dhe te kalciumit.

Procesi teknologjik i prodhimit te gelqeres, eshte ne te vertete nje proces i zberthimit termik, nje proces tipik heterogjen, gjate te cilit jane te pranishme dy komponente ne gjendje te ngurte dhe nje komponent ne gjendje te gazte.

Per teknologjine e prodhimit dhe sidomos per perdorimin praktik te gelqeres ka rendesi te posacme fakti se guri gelqeror, megjithese gjate pjekjes humb afro 50% te masses se tij, nuk tkurret dukshem, keshtu qe gelqerja si produkt i zberthimit te tij perftohet ne forme te nje materiali mjaft poroz. Poroziteti i gelqeres varet prej temperatures se pjekjes dhe natyres se lendes se pare.



3. PËRSHKRIMI I MJEDISIT NË ZONË

5.1. Mjedisi fizik

5.1.1 Gjeologjia

Zona në të cilën zhvillohet aktiviteti I Prodhimit te gelqeres gjendet në një strukturë antiklinale të nënzonës së Beratit, që i përket brezit të rrudhosur mbulesor Jonian. Sa i takon kolonës së plotë stratigrafike të zonës ku gjendet territori në studim, nga poshtë – lart, dallohen: Depozitimet më të vjetra në këtë rajon janë ato të Kretakut të Sipërm (Cr2), që përbëjnë krahët dhe kulmin e strukturës së rrudhosur. Këto depozitime përfaqësohen nga gëlqerorë shtresorë deri në masivë të alternuar me gëlqerorë mikritikë me shtresëzim të dobët. Ata kanë trashësi mbi 370 m. Mbi Depozitimet e Kretakut të sipërm, shtrihen normalisht ato të Paleocenit (Pg1), të përbërë nga gëlqerorë turbiditikë, gëlqerorë masivë me ndërfaqje shtresore të gëlqerorëve shtresëshollë. Trashësia e depozitimeve të Paleocenit varion nga 100 m deri në 120 m. Në të gjithë zonën, në krahët e strukturave të rrudhosura, shtrihen depozitimet e Eocenit (Pg²). Prerja përbëhet nga gëlqerorë turbiditike, që kalojnë në gëlqerorë shtresore biomikritikë e mikritikë, të pasuar nga mergele argjilore. Trashësia e tyre arrin në rreth 200 m.

Në krahët e strukturave të rrudhosura takohen gjithashtu depozitimet e Oligocenit të poshtëm (Pg3¹) dhe Oligocenit të mesëm (Pg3²). Vërehet kalimi nga formacioni flishoidal në atë mergelor të pakos kalimtare. Depozitimet e Oligocenit të poshtëm janë rreth 840 m të trasha ndërsa ato të oligocenit të mesëm rreth 700 m. Depozitimet e ligocenit të sipërm (Pg3³) kanë përhapje të kufizuar në krahasim me ato të Oligocenit të poshtëm dhe të mesëm dhe takohen në rrudha si ndërfaqje të ranorëve argjilo-aleurolitike me ranorë masivë dhe me shtresa të rralla gëlqerori. Depozitimet e Oligocenit të sipërm kanë trashësi rreth 1140m.

Sedimentet e Kuaternarit përbëhen nga proluvionet (guraleca argjilore pjesërisht të rumbullakosura) dhe nga deluvionet (brekçie karbonatike), të cilat janë shumë të përhapura në shpatet e maleve.

Sizmiciteti i zonës

Zona është vendosur në sistemin e thyerjeve reversibile me rënie midis V-JL dhe VVP-JJL të zonave sizmogjenike Adriatike dhe Jonike, dhe ngjitur me zonën sizmogjenike Lushnje- Elbasan-Dibër. Në këtë territor mund të bien tërmete me Mmax të pritshme midis 6.0 dhe 6.9 (Aliaj, 2004). Sipas Hartës së Sizmicitetit të Shqipërisë ky territor përdhëhet në Zonën e Shkallës VIII të MSK-64, të shkallës së intensitetit sizmik.



Figura 4 Harta Gjeologjike e zones ne vleresim

3.1.2 Gjeomorfologjia

Nga pikpamja e shtrirjes gjeografike, zona në studim është pjesë e luginës së Osumit, asaj pjese të saj që përfshihet në Ultësirën Perendimore.

Sa i takon morfologjisë, ky rajon përfaqëson një reliev kodrinor me organizim të çrregullt, në të cilin vend të rëndësishëm zenë luginat e përrenjve që e përçajnë atë në drejtime të ndryshme. Territori i propozuar për zhvillimin e aktivitetit shtrihet në tarracat lumore të krijuara nga rrjedha e poshtme e Osumit. Lugina e Osumit është në një stad pjekurie. Karakteristike, ashtu si edhe për disa lumenj të tjerë të vendit tonë, është zhvillimi i tarracave dhe zallishtores kryesisht në anën e djathtë të lumit. Ky fenomen duhet të ketë lidhje me pozicionin e shtratit të lumit (nga e majta) përkundrejt strukturës sinklinale të Poliçanit.

3.1.3 Tokat

Në zonën ku gjendet aktiviteti dallohen Tokat Livadhore Aluvionale dhe ato Livadhore të Hinjta Kafe. Tokat Livadhore Aluvionale janë të formuara mbi depozitimet proluviale të Kuaternarit dhe takohen kryesisht shumë pranë brigjeve të Osumit. Ato janë të formuara nga depozitime të materialeve të trasha si zaje, gurë, zhavorr dhe rërë në të dy krahët e rrjedhës së lumit. Këto toka kanë profil pak të zhvilluar dhe me karakter të theksuar shtresor. Në pjesët e buta dhe me bimësi diferencohet horizonti A dhe profili i tokave është A-C. Aftësi ujëmbajtëse e tyre është e vogël. Ndonëse ujërat nëntokësorë nuk janë shumë thellë, ato nuk arrijnë të ushqejnë shtresat e sipërme pasi ngjitja kapilare e tyre është e pamundur. Kjo është arsyeja që përgjithësisht gjatë verës këto toka janë të thata. Janë toka me përmbajtje të ulët të elementëve ushqyes, ndërsa përmbajtja humusit varion nga 0.15-0.4% në sipërfaqe në 0.1% në thellësi. Mosha relative e tokave aluvionale është krahasimisht më e vogël se e llojeve të tjera të tokave. Këto toka janë të përshtatshme për të gjitha bimët bujqësore por, vetëm nëse trajtohen me kujdes veçanërisht në drejtim të prishjes së kores dhe vlerave biologjike që ajo përmban, si dhe, nëse evitohen depozitimet e reja të lumenjve. Tokat Livadhore të Hinjta Kafe janë të përhapura në të gjithë zonën fushore bregdetare të vendit, ku përfshihet edhe rajoni në studim. Ato krijohen mbi depozitime aluviale dhe deluviale, në kushte të nivelit të lartë të ujërave nëntokësorë, i cili ndikon në zhvillimin e bimësisë livadhore. Prandaj edhe procesi pedogjenetik i formimit të tyre dominohet nga procesi i livadhëzimit (prej nga vjen edhe emri Livadhore të Hinjta Kafe). Ato kanë profil të diferencuar dhe ngjyrë që ndryshon nga e hinjtë e errët (në sipërfaqe) në të hinjtë të verdhë (në thellësi). Përbërja varion nga argjilore në subargjilore. Në horizontet e poshtme gjenden akumulime karbonatesh (CaCO_3). Për nga cilësitë kimike, këto toka paraqiten neutrale në reaksion, të pasura në carbonate kalciumi, mesatare në azot, fosfor dhe humus. Sa i takon përmbajtjes së elementëve lehtësisht të asimilueshëm nga bimët, këto toka paraqiten mesatarisht të varfëra në fosfor dhe të pasura në kalium.

3.1.6 Ujërat

Zona e propozuar për zhvillimin e aktivitetit gjendet shumë afër rrjedhës së poshtme të lumit Osum, i cili rrjedh rreth 350 m në perëndim të saj. Osumi përfaqëson edhe burimin uhor sipërfaqësor më të rëndësishëm në zonë. Ai është degë kryesore e Semanit, është 161 km l gjatë, ka një sipërfaqe ujëmbledhëse prej 2'150 km², lartësia mesatare 828 m, prurje mesatare shumëvjeçare 32, 5 m³/s dhe rrjedhje të pakta prej 17,5 l/s/km². Uji ka mineralizim mesatar prej 345 mg/l.

Osumi është një ndër lumenjtë kryesorë të Krahinës Malore Jugore. Prurja e tij pëson luhatje të theksuara gjatë vitit dhe për nga sasia e prurjes së lëngët ai renditet ndër lumenjtë mesatarë të vendit.

3.1.7. Klima

Zona në të cilën zhvillohet aktiviteti përfshihet në pjesën qendrore të Zonës së Klimës Mesdhetare Fushore. Kjo zonë përfshin të gjithë pjesën e ulët dhe bregdetare të Shqipërisë dhe karakterizohet nga regjim klimatik i tipik mesdhetar. Reshjet më të mëdha bien gjatë stinës së vjeshtës dhe të dimrit, kryesisht në formë shiu. Dëbora është një dukuri e rallë dhe e papërfillshme. Në këtë zonë vrojtohen mesatarisht 2550.0-2850.0 orë me diell, temperatura mesatare vjetore luhatet 15.0-16.00C, temperatura mesatare e muajit janar, i cili është muaji më i ftohtë i vitit, luhatet në kufijtë 8-10 °C, ndërsa temperatura e muajit gusht, i cili është më i nxehti, në kufijtë 24-26 °C. Sasia mesatare e reshjeve vjetore luhatet në kufijtë 1000.0 – 1200.0 mm, ndërsa numri i ditëve me reshje >1.0 mm luhatet 85-100 ditë. Drejtimi dominant i erës është ai i veriperëndimit, ndërsa shpejtësia mesatare 2.0 – 3.5 m/s.

3.1.8. Zhurma

Aktiviteti gjendet në zonë rurale ku niveli i zhurmave është përgjithësisht i pranueshëm. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Shëndetësisë kanë nxjerrë Udhëzimin nr.8 datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, i cili bazohet në rekomandimet e OBSH. Objekti në fjale ndodhet larg banesave dhe niveli i zhurmave gjatë matjeve në vend të disa viteve në këto aktivitet rezultojnë te jete 75 – 81 dB(A).

3.2 Mjedi biologjik

3.2.1 Habitatet e zonës në studim

Rajoni fitogjeografik ku gjendet zona ku propozohet të zhvillohet aktiviteti mbështet një territor të gjerë habitatesh natyrale dhe gjysëmnatyrale. Llojet kryesore të habitateve në zonën e studimit janë:

- Makia (Shkurretat sklerofite përherë të gjelbërta);
- Pyjet sklerofite përherë të gjelbërta të dominuara nga ilqja Quercus ilex;
- Pyjet halore mesdhetare (Pyjet e mbjellë me pisha mesdhetare);
- Habitatet ujore dhe të brigjeve (ujërat lëvizës).

3.2.2 Fauna e zones

Nga vrojtimet në terren dhe burimet dytësore të informacionit vlerësohet se zona në studim mund të strehojë apo mbështesë rreth 189 lloje kafshësh apo 36% të totalit të njohur në Shqipëri ku përfshihen peshqit, amfibët, zvarranikët, shpendët dhe gjitarët.

3.2.2 Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës

Zonat e mbrojtura bashkë me monumentet e natyrës përfaqësojnë një rrjet sipërfaqesh që mbrohen në shkallë të caktuar, sipas përcaktimeve kategorike të tyre, për shkak të vlerave natyrore kombëtare, por edhe rajonale e globale.

Zona e propozuar për zhvillimin e aktivitetit prodhim nuk gjendet brenda asnjë zone të mbrojtur. Njëkohësisht referuar VKM nr.676 datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare” zona e zhvillimit të aktivitetit nuk ndërpret asnjë nga monumentet e natyrës të rrethit të Beratit.




Figura 5 Zonat e mbrojtura në lidhje me sipërfaqen ku zhvillohet aktiviteti

3.4 Mjedisi social

Administrativisht zona në të cilën gjendet aktiviteti përfshihet në territorin e Bashkisë Dimal (Ura Vajgurore), të rrethit të Beratit, në Qarkun e Beratit. Bashkia Dimal përfshin nën administrimin e saj qytetin e Urës Vajgurore dhe fshatrat Bistrovë, Guri I Bardhë, Konisbaltë, Pashalli, Vokopolë dhe Skrevan. Kjo bashki numëron rreth 12’266 banorë.



Figura 6 Harta me kufijtë e Bashkisë Dimal (Ura Vajgurore)

Që me rënien e komunizmit, zona dëshmon ndryshime rrënjësore demografike duke ndjekur kështu prirjet në shkallë vendi. Popullsia ka rënë për shkak të migrimit të jashtëm dhe të brendshëm ndërkohë që emigrimi i përkohshëm dhe i përhershëm përfaqëson një dukuri normale. Shkaku kryesor është mungesa e mundësive për punësim. Emigrimi jashtë vendit është i zakonshëm ndërsa ai i brendshëm evidentohet kryesisht në drejtim të Tiranës, Fierit dhe Durrësit.

Emigrimi drejt Beratit është shumë i paktë për shkak të mungesës edhe në këtë qytet të mundësive të punësimit. Imigrimi në zonë është shumë i kufizuar.

Aktivitetet kryesore ekonomike të zonës përfshijnë nxjerrjen dhe përpunimin e materialeve të ndërtimit, ndërtimin, prodhimin bujqësor e blegtoral, kërkimin e rezervave të naftës, si dhe aktivitete të ndryshme tregtare. Ndërmarrjet industriale që kanë funksionuar në zonë, e kishin të pamundur të konkuronin me fluksin e mallrave të importit që shoqëroi rënien e komunizmit në 1990. Këto ndërmarrje u mbyllën përfundimisht, ose u privatizuan me një kapacitet prodhues shumë të limituar. Kjo situatë çoi në rënien e ekonomisë në zonë. Edhe prodhimi bujqësor dhe blegtoral ka rënie krahasuar me periudhën e para viteve 1990. Kjo rënie e prodhimit është shkaktuar edhe si pasojë e dëmtimeve në rrjetin e infrastrukturës së vaditjes, rritjes së kostove të prodhimit dhe mungesës së tregjeve. Prodhimi bujqësor është i kufizuar në ngastra të vogla familjare. Bimët kryesore që kultivohen janë gruri, misri, perimet, foragjeret, ullinjtë, pemët frutore dhe vreshtat. Blegtoria konsiston në tufat e lopëve, deleve dhe dhive, pularitë dhe bletërritje. Kultivimi vitet e fundit l pemëve frutore ka çuar në një përmirësim të prodhimit.

4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS

4.1 Metodika e aplikuar për vlerësimin e ndikimeve në mjedis

Çdo aktivitet që zhvillohet në mjedis shoqërohet me pasoja dhe ndikime të një shkalle të caktuar, megjithatë, e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve; forma e shfaqjes së tyre, dhe në mënyrë më analitike ndikimet e çdo operacioni të kryer, sidomos mbi burimet natyrore të parinovueshme.

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e zhvillimit të aktivitetit bëhet duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Për një vlerësim sa më profesional të ndikimeve dhe pasojave të projektit në mjedisin fizik dhe social është përzgjedhur të aplikohet metodika dhe procedurat e mëposhtme:

- Evidentimi i problematikave të teknologjise dhe mënyra e operimit;
- Kontroll, survejim i infrastrukturës ekzistuese dhe nevojën për infrastrukturë të re;
- Njohja me masat e marra për minimizimin e ndikimeve të shkaktuara nga funksionimi i aktivitetit në mjedisin e zones;
- konsultimi me shumë dokumenta e raporte të VNM për veprimtari të njëjta.

Për të ndjekur një rrjedhë logjike të vlerësimit të ndikimeve në mjedis, procesi është konceptuar në faza që përkojnë me fazen aktuale të zhvillimit të aktivitetit dhe konkretisht:

- në fazën e funksionimit;
- në fazën e mbylljes, rehabilitimit të sipërfaqes dhe riaftësimin të proceseve natyrore.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis identifikon llojet e mëposhtme:

- Ndikimet negative;
- Ndikime pozitive;
- Ndikimet e drejtpërdrejta që vijnë nga operacionet që janë pjesë përbërëse e aktivitetit;
- Ndikimet jo të drejtpërdrejta të cilat janë të dukshme dhe shkaktojnë efekte në një tjetër drejtim;
- Ndikimet kumulative, të dukshme, të krijuara nga akumulimi i efekteve të dukshme në një zonë të veçantë, rishfaqja e efekteve të disa llojeve në zona të ndryshme, ose bashkëveprim të efekteve të ndryshme për shumë kohë ose nga kombinimi i efekteve të ardhura si pasojë e bashkëveprimit me projekte të tjerë të mundshëm.

Është e rëndësishme të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte ose indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve:

- Ndikime të kthyeshme në mjedis,
- Ndikime të pakthyeshme në mjedis.

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së aktivitetit dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim e proceseve natyrore dhe rigjenerim të ekosistemit.

Industria minerare shoqërohet me ndikime mjedisore negative, të cilat në disa raste mund të jenë të pashmangshme. Megjithatë, shumë prej ndikimeve negative mjedisore mund të minimizohen përmes një planifikimi të kujdesshëm mjedisor dhe aplikimit të teknikave dhe teknologjisë së parandalimit të ndotjeve.

4.2 Përcaktimi i sinjifikancës së ndikimeve

Në tabelën e mëposhtme jepet një kategorizim i rëndësisë së çdo ndikimi të mundshëm negativ në mjedis të aktivitetit Furre Gelqere që zhvillohet. Ky kategorizim është kryer bazuar në vlerat mjedisore të zonës, legjislacionin mjedisor në fuqi dhe njohuritë mbi teknologjinë dhe teknikën e kryerjes së operacioneve ndërtimore dhe shërben për hartimin e një Plani menaxhimi efikas për kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve negative të identifikuara gjatë procesit të VNM.

Tabela 5.1 - Metodika e vlerësimit të rëndësisë së ndikimeve të mundshme negative në mjedis

Kategoria	Përshkrimi
I ulët	Ndikimi është i përkohshëm, dëmton pak vlera natyrore si në cilësi dhe në sasi (volume). Me përfundimin e operacionit që e shkakton ai nuk jep më efekte në mjedis
I mesëm	Ndikimi është i përkohshëm por në mungesë të masave kontrolluese dhe menaxhuese mund të shkaktojë ndikime afatgjata në vlerat natyrore. Sipërfaqja që tjetërsohet nuk rikthehet më në gjendjen e saj por zë një raport të pranueshëm me sipërfaqen totale të zonës (koeficienti i tjetërsimit) si dhe tjetërsohet vetëm sipërfaqja ku zhvillohet aktiviteti. Ndikimi nuk përfaqëson shkarkime të ndotësve në mjedis
I konsiderueshëm	Ndikimi është i përhershëm dhe del përtej zonës së ndikuar (zhvendosje, ndotje, zhurma e shkarkime në ajër). Ndikimi kompromenton normat e shkarkimeve në

	mjedis dhe normat e përdorimit të mjedisit
I kthyeshëm	Mbaron efektin me ndalimin e shkakut (i përkohshëm) dhe mjedisi i ndikuar rifiton gjendjen e tij natyrale. Dëmton vlera/zona të mbrojtura dhe unikale
I pakthyesëm	Pasojat e ndikimit janë të pakthyeshme (vazhdojnë efektin negativ në mjedis) edhe pasi përfundon veprimi që shkakton ndikimin

4.3. Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis

Siç është treguar që në paragrafët e parë të këtij raporti, aktiviteti zhvillohet në një kantjer ekzistues prodhimi të gelqeres me furre vertikale teknologji e viteve 40 perdoret prej disa dekadave shfrytëzohet nga ky investitor. Kjo do të thotë që e gjithë infrastruktura e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit është e gatshme dhe zhvillimi i aktivitetit nuk do të shoqërohet me ndikime të tilla të rëndësishme siç janë, ndryshimi i destinacionit të përdorimit të tokës apo dëmtim vejetacioni, të cilat karakterizojnë fazën përgatitore të aktivitetit (përgatitjen e kantjerit dhe infrastrukturës).

Ndikimet e mundshme në mjedis të aktivitetit mund të identifikohen sipas fazave nëpër të cilat do të kalojë procesi i prodhimit dhe trgtimit te gelqeres, përkatësisht,

- Transportit të lendes se pase (gurit gelqeror, qymyrit te koksit);
- Depozitimet e tyre ne ambjentet e aktivitetit;
- Futja e tyre ne furren vertikale per prodhimin e gelqeres
- Nuk kemi gjenerim mbetjesh te ngurta nga procesi

4.3.1 Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis gjatë transportit të lendeve te para dhe produktit perfundimtare

Gjatë transportit të lendeve te para,- Guri Gelqeror merret me automjetet e vete shoqerise se Z. Petrit Mamushi, ne firmen "MUSTAFAJ" ne nje distance prej 1 km larg ne vije ajrore dhe lenda e pare(-qymyri i koksit)merret brenda territorit te qarkut Berat.

Keto lende transportohen deri ne siperfaqen ku zhvillohet aktiviteti per prodhimin e gelqeres me furre vertikale.

Gjate transportit mund të ndodhë:

- Gjenerim i një sasie pluhuri, ndikim i cili do të jetë më i ndjeshëm në stinën e thatë;
- Gjenerim në ajër i sasive të caktuara të gazeve të djegies NOx dhe SOx;
- Shqetësim i shtresave të tokës dhe ngjeshje e saj, vibrime;
- Ndotje e mundshme e tokës si pasojë e avarive të mekanikës të cilat mund të bëhen shkak për rrjedhje lubrifikantësh dhe karburantësh.

4.3.2 Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në

mjedis gjatë depozitimit në aktivitet te lendeve te para

Gjatë proceseve të depozitimit të lendeve te para ne aktivitet mund të shfaqen këto ndikime negative në receptorët e veçantë të mjedisit;

- Ngjeshje e shtresave të tokës në sektorin e caktuar për depozitimi i tyre;
- Emetim pluhuri në ajër nga masat e lendeve te para;
- Ndotje e mundshme e tokës nga substanca të lëngëta të cilat mund të vijne si pasoje e ndikimit te lendeve te para nga agjentet atmosferik dhe transportimi i tyre drejt trupave ujorë të zonës;

4.4. Kategorizimi i ndikimeve të identifikuara (sinjifikanca)

Bazuar në ndikimet e identifikuara sipas fazave nëpër të cilat kalon lenda e pare deri ne prodhimin e gelqeres, në tabelën e mëposhtme jepet një kategorizim I shkallës së ndikimeve sipas operacioneve dhe receptorëve të mjedisit. Kategorizimi është kryer mbështetur në natyrën e ndikimit, duke kombinuar dëmin e tij në mjedis, mundësinë që të shfaqet, kohëzgjatjen e tij.

Fazat e trajtimit (me operacionet përkatëse)	Lloji i ndikimit	Sinjifikanca e ndikimit		
		I ulet	I mesem	I larte
Transport i L. para nga prodhuesi në sipf e aktivitetit ku prodhohet gelqerja	Gjenerim pluhuri			
	Gjenerim i gazeve të djegies NOx dhe SOx			
	Ndotje e mundshme e tokës nga rrjedhjet e lubrifikantëve dhe karburanteve si pasojë e avarive të mekanikës			
Depozitimi dhe futja ne proces e l.te para per prodhimin e Gelqeres	Ngjeshje e shtresave të tokës në sektorin e caktuar për depozitimin e tyre.			
	Emetim pluhuri në ajër nga masat e l. te para;			
	Ndotje e mundshme e tokës nga substanca të lëngëta të cilat mund të vijne nga ndikimi I agjenteve atmosferik te l.te para			
	Ndotje e mundshme e ujërave ipërfaqësorë dhe nëntokësorë për shkak të shpëlarjes së mbetjeve nën ndikimin e reshjeve dhe transportimit të tyre drejt trupave ujorë të zones			

Siç shihet edhe nga tabela, ndikimet e mundshme në mjedis të aktivitetit ne fjale janë të shkallës së ulët për operacione pune dhe receptorë mjedisorë të veçantë. Kjo për faktin se aktiviteti zhvillohet në një teknologjia e viteve 40, në të cilin kryhet I njeiti aktivitet si vite me pare , me po te njejten teknologji dhe parim pune qe egziston ende dhe sot . Prodhimi I Gelqeres me furra vertikale. Në këtë kontekst, ndikimet e pritshme të aktivitetit janë të njëjta me ato ekzistuese. Mund të ndodhë një rritje e vogël e intensitetit të disa ndikimeve si gjenerimi I pluhurit dhe gazeve, apo çlirimi i zhurmave, ndikime që lidhen me fazën e transportit, i cili do të njohë rritje të volumit krahasuar me aktivitetin që kryhet aktualisht në aktivitet.

4.5 Kohëzgjatja e mundshme e ndikimeve negative të identifikuara

Të gjitha ndikimet e mundshme të identifikuara të aktivitetit kanë shtrirje kohore të njëjtë me vetë aktivitetin. Ndikimet kryesore dhe të përbashkëta për të gjitha etapat nëpër të cilat kalon procesi I prodhimit te gelqeres janë shkarkimet në ajër të pluhurit, zhurmës dhe gazeve. Të gjitha këto ndikime, ndalojnë së qeni të tilla në momentin e mbylljes së aktivitetit. Sa lidhet me ndotjet e mundshme të tokës apo ujërave, bëhet fjalë për ndotje aksidentale të tyre (jo sistematike), eliminimi i të cilave do të bëhet menjëherë sipas masave që përcaktohen në Planin e Menaxhimit të Mjedisit. Gjykuar nga natyra e aktivitetit nuk parashikohen ndotje aksidentale të përmasave të tilla që të kenë shtrirje të gjatë në kohë, edhe pas mbylljes së aktivitetit.

4.6 Shtrirja e mundshme hapsinore e ndikimeve negative në mjedis

Shtrirja hapsinore e ndikimeve të aktivitetit është e kushtëzuar nga faktorë të tillë si, vendodhja e zonës së aktivitetit, vlerat biologjike të saj, teknologjia e prodhimit te gelqeres si dhe, distanca nga zonat e banuara. Shtrirja hapsinore e ndikimeve të parashikuara të veprimtarisë do të jetë e njëjtë me ato që janë ekzistuese tanimë pasi aktiviteti është ekzistues dhe funksional.